

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit V. K., nga komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën.par. 1.5 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 PAR. 1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligshmërisë të dënuarit V. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.115/2014 datë 22.06.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.372/2015 datë 12 tetor 2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 prill 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë e të dënuari V. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.115/2014 datë 22.06.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.372/2015 datë 12 tetor 2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.115/2014 datë 22.06.2015, i dënuari V. K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën.par. 1.5 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll,

në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK dhe pasi që më parë i janë përcaktuar dënimet për secilën veprë veç e veç është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 09.02.2014 e tutje. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues, konfiskimi i pushkës së gjuetisë të modelit rus me nr. serik T03-63, 3 fishekë të kësaj pushke, 3 karikatorë të zbrazët të armës automatike AK-47 së bashku me 15 fishekë të kësaj arme dhe 5 fishekë shkollor si objekt i kryerjes së veprës penale. Është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 200 €, ndërsa 100 € në emër të paushallit gjyqësor të gjitha në afat prej 1 (një) muaji pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.372/2015 datë 12 tetor 2015, si në vijim:

“Me aprovimin e ankesave të dëmtuarve L. Sh. dhe F. Sh., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, PKR.nr. 115/2014 datë 22.06.2015, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të Kosovës të akuzuarit V. K. për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën.par. 1.5 të KPRK, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite. Dënimi i shqiptuar për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, merret si i vërtetuar. Andaj, Gjykata e Apelit të Kosovës në pajtim me nenin 80 të KPRK, të akuzuarit i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 09.02.2014 e tutje.

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit V. K., refuzohet si e pabazuar.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pandryshuar”.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari V. K. për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që kërkesa të aprovohet, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr. 60/2016 datë 25.03.2016, ka dhënë përgjigjen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, i dënuari thekson se dy aktgjykimet e gjykatave janë marrë me shkelje të ligjit penal e cila shkelje sipas të dënuarit konsiston në atë se me rastin e matjes së dënimit të dy gjykatat vetëm i kanë konstatuar rrethanat lehtësuese, ndërsa ato fare nuk janë vlerësuar siç janë se i dënuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendimin e thellë për veprën e kryer. Kështu, sipas pretendimeve në kërkesë, rrethanat personale të të dënuarit se i njëjti ka vepruar në gjendje të tronditjes së thellë emocionale në momentin e kryerjes së veprës penale meqë i dëmtuari në orët e vona të natës ka ardhur në shtëpinë e tij për ta marrë bashkëshorten dhe fëmijën e tij fakt ky i cili e ka provokuar veprimin nga i dënuari. Këto rrethana nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, gjë që nuk e ka bërë as gjykata e shkallës së dytë kur ia ka shqiptuar dënimin maksimal dhe kështu është shkelur ligji penal në dëm të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit nga këto arsye.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari V. K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën.par. 1.5 të KPK dhe për këtë veprë i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar nga neni 374 par. 1 të KPK, për të cilën veprë i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj.

Gjykata e shkallës së dytë, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkritazi me vendimin për dënimin në raport me veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179

par. 1 nën.par. 1.5 të KPK dhe për këtë vepër ka përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK, dënimin e shqiptuar e ka marrë si të vërtetuar dhe e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara nga dispozita e nenit 73 të KPK, ashtu si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale meqë përpos që ka privuar nga jeta të ndjerin L. Sh., ka rrezikuar edhe jetën e personave tjerë të pranishëm natën kritike si dhe dashjen e të akuzuarit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar sjelljen korrekte të akuzuarit gjatë shqyrtimeve gjyqësore, shprehjen e keqardhjes nga ana e tij për veprën e kryer. Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata e shkallës së dytë, ka vlerësuar si rrethanë rënduese faktin se i dënuari V. K. ka manifestuar vendosmërinë e lartë për ta privuar nga jeta edhe tani të dëmtuarin L. Sh. me ç'rast ka rrezikuar edhe persona të tjerë prezent edhe pse tani i ndjeri L. e as i dëmtuari L. nuk i kishin dhënë shkas të akuzuarit për sulm e as që e kishin pritur sulmin nga ai, prandaj edhe nuk kanë mundur që të mbrohen. Po ashtu, si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i dënuari e ka privuar nga jeta mikun e shtëpisë rrethana këto të cilat paraqesin intensitetin e lart të rrezikshmërisë, prandaj të dënuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitë të aktgjykimit duke pritur se një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me ligj.

Dispozita e nenit 73 të KPK parashikon rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit ashtu që konform paragrafit 1 kësaj dispozite janë paraparë në mënyrë të përgjithësuar se cilat rrethana gjykata do t'i marr parasysh gjatë matjes së dënimit dhe me atë rast i cek rrethanat më tipike lehtësuese dhe rënduese, duke ia lënë mundësinë gjykatës që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethanat tjera, të cilat ndikojnë që të shqiptoj dënimin më të rreptë apo më të butë. Në mesin e rrethanave që parashihen me paragrafin 1 gjenden rrethanat objektive që i referohen veprës penale dhe ato subjektive që i referohen kryerësit. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë ato rrethana të cilat janë prezentë me rastin e kryerjes së veprës penale, por nuk janë element të saj, nuk hyn në figurën e saj.

Në rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtorë, pra vrasje e rëndë sipas dispozitës së nenit 179 par 1 është përcaktuar

dënimi jo më pak se 10 (dhjetë) vjet ose me burgim të përjetshëm. Pra, në këtë rast nuk ka dyshim se gjykata e shkallës së parë, dhe ajo e shkallës së dytë duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal, përmes institutit të matjes së dënimit në kuptim të dispozitave të lartcekur ka bërë individualizimin e dënimit dhe ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor brenda kufijve të përcaktuar me ligj për këto vepra penale, për çfarë gjykata e shkallës së dytë lidhur me ashpërsimin e dënimit ka dhënë arsye në faqen 4 të aktgjykimit, të cilat si të drejta dhe të ligjshme e pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyet e lartcekura, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.87/2016, më 7 prill 2016

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj